

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6573  
E enjte, 31 mars 2022  
çmimi 0.40 €

NATO-ja në vitin 2023  
hap bazën e rinovuar  
ajrore në Kuçovë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TËRHEQJA E MJETEVE TË TRUSTIT MERR PËRKRAHJEN NGA TRI PARTITË OPOZITARE,  
PDK-ja, LDK-ja DHE AAK-ja, JO EDHE NGA LV-ja | FAQE 4-5

## TRUSTI I GATSHËM TA ZBATOJË TËRHEQJEN E 30-PËRQINDËSHIT TË KURSIMEVE



Kryesuesi i Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, Ruzhdi Morina, ka thënë se janë të gatshëm ta zbatojnë çdo vendim të Kuvendit të Kosovës në lidhje me tërheqjen e kursimeve nga Trusti. "Ne vazhdojmë ta mbajmë pozicionin se nuk dëshirojmë të përfshihemi në këto iniciativa. Kjo është kompetencë e Kuvendit të Kosovës. Jemi të gatshëm ta zbatojmë secilin vendim që e sjell Kuvendi", ka thënë Morina. Tri partitë opozitare, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, janë deklaruar pro një vendimi të tërheqjes së mjeteve nga Trusti. Por, një iniciativë të tillë nuk është duke e përkrahur partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje


### OPINION

PËR ÇFARË LUFTE  
NË KOSOVË E KENI FJALËN,  
O MBURRAVECË! | F. 8

Behxhet Sh. SHALA  
- BAJGORA



### AKTUALE



KOSOVA DHE SHQIPËRIA  
DISKUTOJNË PËR RITJEN E  
BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN  
E SIGURISË DHE MBROJTJES | F. 3

MBI 500 RASTE AKTIVE ME COVID  
DHE 30 RASTE TË REJA | F. 4

### EKONOMI



PROJEKTLIGJI PËR PAGA, RREZIK  
NGA SHPËRTHIMI I PAKËNAQËSIVE  
SOCIALE | F. 9

SHPËRNDAHEN 400 PAKO  
USHQIMORE PËR FAMILJET  
NË NEVOJË | F. 9

### SPORT

FFK-ja PUBLIKON DATAT  
E NDESHJEVE TË KOSOVËS  
PËR LIGËN E KOMBEVE | F. 10

REAGIM I KMDLNJ-së

Vizitat familjare  
dhe vizitat  
speciale në  
Gjykatën Speciale!  
| FAQE 3



NULAND: RUSIA PO PËSON  
HUMBJE TË MËDHA NË UKRAINË  
| FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Nuland: Rusia po pëson humbje të mëdha në Ukrainë

WASHINGTON, 30 MARS - Rusia është duke pësuar humbje "të mëdha" që prej se nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës, tha një zyrtarë e lartë e Departamentit Amerikan të Shtetit, duke shtuar se numri i ushtarëve rusë është mbi 10 000. "Mendoj se, fatkeqësisht, rusët ende nuk e kanë kuptuar plotësisht se sa e fortë është ushtria ukrainase", tha nënsekretarja amerikane e Shtetit, Victoria Nuland, gjatë një interviste për "Current Time". "Pala ruse po pëson humbje shumë të mëdha dhe, sipas vlerësimeve tona, janë mbi 10 000 rusë të vdekur", tha Nuland.

Që prej nisjes së pushtimit të Ukrainës më 24 shkurt, Rusia vetëm dy herë ka dhënë shifra sa iu përket ushtarëve që i janë vrarë. Shifrat e prezantuara nga Rusia kanë qenë më të ulëta krahasuar me vlerësimet e paraqitura nga Perëndimi dhe Ukraina.

Më 2 mars Ministria e Mbrojtjes e

në pjesë të tjera të Ukrainës dhe do të vazhdojnë ta bombardojnë Mariupolin e Hersonin dhe pjesë të tjera të vendit", tha ajo. "Zgjidhjet diplomatike të konfliktit zakonisht vijnë pas një armëpushimi, jo në mes të luftimeve. Dhe rusët absolutisht nuk kanë qenë të gatshëm të ketë një armëpushim të plotë në mënyrë që negociatat të bëhen serioze", u shpreh Nuland, duke shtuar se kushdo që negocion për dhënie fund të konfliktit duhet të sigurojë se Ukraina do të jetë në gjendje në të ardhmen ta parandalojë përsëritjen e agresionit. "Prandaj, Ukrainës do t'i duhet një lloj mbështetjeje e sigurisë për arsenalin e saj që iu desh të përdorte në këtë konflikt, nëse i duhet që ta ndalë Rusinë që të tentojë sërish. Prandaj, ne do të vazhdojmë, që së bashku me aleatët dhe partnerët tanë, të ofrojmë mbështetje të fuqishme të sigurisë për Ukrainën".

E pyetur nëse Perëndimi do t'i



mbështetje të rëndësishme të sistemeve të mbrojtjes ajrore për Ukrainën".

Ajo, po ashtu, paralajmëroi se nëse Rusia nuk e ndalon agresionin e saj ndaj Ukrainës rezikim që të përballet me më shumë sanksione nga Perëndimi. "Për aq kohë sa lufta vazhdon ne dhe aleatët dhe partnerët tanë planifikojmë ta rritim presionin ndaj [presidentit rus, Vladimir] Putin dhe qeverisë së tij në baza javore dhe do t'ia mohojmë atij paratë që i duhen për makinën e tij të luftës", tha Nuland.

## Kievi i kërkon Moskës të tërhiqet nga Çernobili pas rrezikut për shpërthime

Zëvendëskryeministrja e Ukrainës, Iryna Vereshchuk, tha se forcat ruse që kanë marrë nën kontrollin e çmontuar bërthamor të Çernobilit duhet të tërhiqen nga ajo zonë, pasi forcat e armatosura ukrainase kanë

paralajmëruar se mund të ketë shpërthim të municioneve. "Ne kërkojmë nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së që menjëherë të marrë masa për çarmatosjen e zonës së ndaluar dhe të vendoset një mision i posaçëm i OKB-së aty për ta zhdukur rrezikun e përsëritjes së një katastrofe bërthamore", tha ajo përmes një videoje të postuar më 30 mars në rrjetin social "Telegram".

Stafi ukrainas ka vazhduar që të operojë me centralin e Çernobilit edhe pasi forcat ruse morën kontrollin e tij më 24 mars në ditën kur Moska nisi pushtimin e Ukrainës. Më 29 mars kreu i Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore, Rafael Grossi, qëndroi në Ukrainë për bisedime me zyrtarët e lartë qeveritarë për ta dërguar "ndihmën urgjente teknike" në mënyrë që të garantohet siguria e centraleve bërthamore ukrainase. "Ne nuk mund të humbim më shumë kohë. Ky

konflikt veçse ka shkakuar dhimbje të paimagjinueshme njerëzore dhe shkatërrim. Ekspertiza dhe aftësitë e agjencisë janë të nevojshme që të parandalohet ndonjë aksident bërthamor", tha Grossi përmes një deklaratë. Në deklaratë nuk u tha se sa kohë Grossi do të qëndrojë në Ukrainë.

Që prej nisjes së luftës Rusia ka marrë kontrollin edhe të centralit bërthamor në Zaporozhja.

## Negociatori ukrainas shpreh optimizëm pas bisedimeve me Rusinë

Negociatori ukrainas Mykhailo Podolyak ka thënë të mërkurën se ndihet optimist pas bisedimeve që ka zhvilluar me palën ruse, në të cilat Moska ka thënë se do t'i zvogëlojë në mënyrë drastike operacionet ushtarake afër Kievit dhe Çernihivit. "Jam optimist për raundin e negociatave në Stamboll", ka thënë Podolyak, duke iu referuar bisedimeve të së martës në Turqi.

Ai ka thënë se sistemi i propozuar i garancive për sigurinë e Ukrainës, i cili do të ofrohet në këmbim të neutralitetit, do të vendoset në referendum, vetëm pasi trupat ruse të tërhiqen nga pozicionet që kanë mbajtur para nisjes së pushtimit në Ukrainë. Kremlini, në anën tjetër, ka zvogëluar shpresat se është arritur përparim në bisedime. "Ne nuk mund të themi se ka pasur diçka shumë premtuese apo ndonjë përparim", ka thënë zëdhënësi i Kremilit, Dmitry Peskov, për gazetarët. Megjithatë, ai ka thënë se Moska e konsideron "pozitive" faktin që Kievi ka filluar t'i shkruajë kërkesat e saj.



Rusisë kishte thënë se 498 ushtarë ishin vrarë, ndërkaq më 25 mars raportoi për 1 351 ushtarë të vrarë rusë. Ndërkaq, zyrtarët ukrainas kanë thënë se numri i ushtarëve të vrarë rusë është mbi 17 000.

Shifrat e prezantuara nga Rusia dhe Ukraina janë të pamundura që të konfirmohen në mënyrë të pavarur. Nuland tha se Shtetet e Bashkuara kanë mirëpritur raundin e bisedimeve Ukrainë - Rusi që u mbajt më 29 mars në Stamboll, por theksoi se pa ndalimin e armiqësive nuk mund të zhvillohet asnjë negociatë serioze. Derisa nuk ka një armëpushim të vërtetë, nuk mendoj se do të shohim bisedime serioze", tha ajo.

Nuland tha se vendimi i Moskës për t'i ripozicionuar forcat e saj, siç njoftoi më 29 mars zëvendësministri i Mbrojtjes së Rusisë, Aleksandr Fomin, ishte "rezultat i drejtpërdrejtë i rezistencës së fortë që ukrainasit po bëjnë jashtë Kievit dhe në Çernihiv". "Megjithatë, ne e dimë se ky është vetëm ripozicionim i forcave ruse dhe ata do të shkojnë

përgjigjet kërkesës së presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, për sisteme të mbrojtjes ajrore nga shtetet që kanë qenë pjesë e Bashkimit Sovjetik, Nuland tha, pa dhënë detaje, se "e konfirmoj se jemi duke e shqyrtuar këtë gjë dhe veçse kemi ofruar



## Kosova dhe Shqipëria diskutojnë për rritjen e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes

PRISHTINË, 30 MARS (ER) - Në kuadër të vizitës dyditore në vendin tonë, delegacioni i Komisionit për Politikën e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, kryesuar nga kryetarja Mimi Kodheli, të mërkurën ka vizituar Ministrinë e Mbrojtjes. Me këtë rast, ata u pritën nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe stafi i lartë i ministrisë. Në takimin e

realizuar me këtë rast u diskutua për nivelin e bashkëpunimit dhe planeve konkrete të deritashme mes dy vendeve tona në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Nga kryetarja Kodheli, njëherësh zëvendës-presidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, u dha zotimi i fuqishëm për mbështetje nga pozicioni i saj në synimet tona në procesin e integrimi

euroatlantike dhe lobimin te vendet mosnjohëse, anëtare të NATO-s. Ndër shumë çështje të tjera të rëndësishme të diskutuara, nga të dyja palët u vlerësua nevoja për një qasje dhe bashkëveprim më të shtuar nga dy qeveritë tona, në kontekstin e ri gjeopolitik, si dhe sfidave potenciale që cenojnë mjedisin e sigurisë sonë dhe rajonit në përgjithësi.



REAGIM I KMDLNJ-së

## Vizitat familjare dhe vizitat speciale në Gjykatën Speciale!

Aktualisht në Njësinë e Paraburgimit të Gjykatës Speciale në Hagë po mbahen të arrestuar tetë shtetas të Kosovës, të gjithë ish ushtarë të UÇK-së, ata që e themeluan UÇK-në e që i dhanë kuptim dhe përmbajtje luftës për liri dhe çlirim të Kosovës dhe të cilët pas përfundimit të luftës ishin bartës më të lartë të posteve institucionale dhe shtetërore.

Të akuzuar janë Jakup Krasniqi, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, Hashim Thaçi ish-kryeministër dhe ish-president i Kosovës, Kadri Veseli ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i PDK-së, Rexhep Selimi, ish-shef i GP të LV-së, Hysni Gucati, kryetar i OVL të UÇK-së, Nasim Haradinaj, z/kryetar i OVL të UÇK-së, Salih Mustafa, ish-udhëheqës i BIA-së dhe Pjetër Shala, ish-ushtar i UÇK-së. Deklarativisht Gjykata Speciale është pjesë e sistemit të Drejtësisë së Kosovës ndërsa faktikisht me asgjë nuk dëshmohet kjo, përkundrazi me asgjë nuk identifikohet si e tillë. Gjykata Speciale me aneks Marrëveshjen të sovranitetin e vendimmarrjes e ka bartë mbi vete duke zhveshur Kosovën dhe sistemin e Drejtësisë nga çdo autoritet dhe vendimmarrje, qoftë edhe për shtetasit e saj që aktualisht mbahen peng në këtë Gjykatë. Puna e kësaj Gjykate është kurditur në atë mënyrë që, edhe në rast se të akuzuarve u shkelen të drejtat e njeriut që iu takojnë si të privuar nga liria këto shkelje nuk kanë ku të adresohen. Realisht, Gjykata Speciale i ka dhënë të drejtë



ekskluzive për monitorim Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq i cili, për shkak të angazhimeve dhe metodologjisë së punës nuk bënë monitorime të rregullta dhe Ombudspersonit të kësaj gjykate, një post koti që ka mandat për të drejtat e të punësuarve në këtë Gjykatë dhe jo për të arrestuarit. Këto vizita quhen vizita speciale ndërsa të tjerat janë vizita familjare, pavarësisht postit apo cilësisë së vizitës. Opinioni duhet ta ketë të qartë se ka dallim të madh midis vizitave informuese dhe vizitave monitoruese.

Në vizita informuese llogariten vizitat familjare, të miqve, vizita e vetme e Avokatit të Popullit të Kosovës dhe dy vizita të Ministrisë së Drejtësisë së

Kosovës. KMDLNj i ka bërë kërkesë Gjykatës Speciale për vizitë monitoruese por se nuk ishte lejuar kjo vizitë në kohën kur vizita familjare për KMDLNj është e papranueshme dhe në kundërshtim me mandatin monitorues që e ka dhe në kundërshtim me Marrëveshjen e nënshkruar me MD-së e cila ka dështuar të sigurojë qasje për monitorues të KMDLNj-së ashtu siç parashihet me Marrëveshje. Duket qartazi që MD-së nuk paraqet asnjë autoritet pranë kësaj gjykate prandaj të arrestuarit, shtetas të Kosovë janë të privuar nga e drejta elementare e njeriut që të vizitohen gjatë qëndrimit në paraburgim në këtë mjedis represiv, jotransparent dhe të

mbyllur për monitorues të KMDLNj-së, me një përvojë më tepër se 20-vjeçare në monitorimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. Për monitorim të suksesshëm duhet të plotësohen tri kushte elementare, kompetenca profesionale e monitoruesve, besimi dhe pranimi i personave të privuar nga liria që të vizitohen dha bashkëpunojnë me monitorues dhe kushti i tretë, gatishmëria dhe vullneti i institucioneve të mbajtjes, në rastin konkret të Gjykatës Speciale të lejojë dhe mundësojë monitorimin. Në rastin konkret të privuarit nga liria janë shumë të gatshëm të pranojnë në vizita të rregullta monitorues të KMDLNj-së, monitorues të

KMDLNj-së ishin dhe janë të gatshëm në çdo kohë të bëjnë këto vizita sepse është kërkesë e të të privuarve nga liria dhe familjarëve të tyre por se Gjykata Speciale e ka përkufizuar qartë monopolin e KNKK nga Gjeneva dhe të ashtuquajturit Ombudsperson i Gjykatës Speciale për monitorim i cili as nuk është i efektshëm e as në përfundim me standardet ndërkombëtare për faktin se nuk kemi përmirësim të trajtimit e as parimësi dhe efikasitet në zbatimin e procedurave.

Vizitat e zyrtarëve të MD-së janë më tepër simbolikë e përpjekjes së demonstrimit të një autoriteti institucional e që në këtë Gjykatë ka zero efekte dhe qartazi nuk përkon me mandatin që e ka në sistemin e drejtësisë së Kosovës e që aspak nuk ka ndikim në përmirësimin e kushteve për të arrestuarit. Prandaj, KMDLNj pret dhe thërret që deputetët e Kuvendit të Kosovës, në njërin nga seancat e radhës të diskutojnë për statusin e të arrestuarve në Gjykatën Speciale, të cilët kanë mbrojtje ligjore por nuk iu mbrohen të drejtat e njeriut. Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Kuvendit të Kosovës duhet të ndërmarrë veprime konkrete për këtë çështje ndërsa KMDLNj-ja është e gatshme të dëshmojë para këtij Komisioni dhe të prezantojë pjesë të raportit monitorues nga distanca. Të arrestuarit që po mbahen peng në Gjykatën Speciale janë shtetas të Kosovës dhe konsiderohen të pafajshëm deri në një vendim të prerë të gjykatës përkatëse.

## Muzeu i Burgut të Prishtinës së shpejti do të hapet për publikun

Prishtinë, 30 mars (ER) - Në kuadër të funksionalizimit parashihet kurimi i ekspozitës së përkohshme përmes së cilës prezantohet hulumtimi, dokumentimi dhe materiali i arkivuar që dëshmon përjetimet e të burgosurve politikë të vendit tonë. Në fazën e parë do të kurohet ekspozita e

përkohshme, ndërsa ndërtesa do të jetë nikoqire e ngjarjeve publike. Pastaj do të vazhdohet me shpalljen e ndërtesës aset të mbrojtur të trashëgimisë kulturore dhe projektin e restaurimit për të përmblyllur me ekspozitën e përhershme dhe planin e menaxhimit.

Për këtë është emëruar ekipi

përgjegjës i udhëhequr nga koordinatori Emin Sallahu. Për ta parë gjendjen në të cilën ndodhet Muzeu i Burgut të Prishtinës, ndërtesën e vizitoi ministri Hajrulla Çeku, i shoqëruar nga Hydajet Hyseni, koordinatori Sllahu, grupi profesionist dhe bashkëpunëtorë të tjerë.





TËRHEQJA E MJETEVE TË TRUSTIT MERR PËRKRAHJEN NGA TRI PARTITË OPOZITARE,  
PDK-ja, LDK-ja DHE AAK-ja, JO EDHE NGA LV-ja

# Trusti i gatshëm ta zbatojë tërheqjen e 30-përqindëshit të kursimeve

Kryesuesi i Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, Ruzhdi Morina, ka thënë se janë të gatshëm ta zbatojnë çdo vendim të Kuvendit të Kosovës në lidhje me tërheqjen e kursimeve nga Trusti. “Ne vazhdojmë ta mbajmë pozicionin se nuk dëshirojmë të përfshihemi në këto iniciativa. Kjo është kompetencë e Kuvendit të Kosovës. Jemi të gatshëm ta zbatojmë secilin vendim që e sjell Kuvendi”, ka thënë Morina. Tri partitë opozitare, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, janë deklaruar pro një vendimi të tërheqjes së mjeteve nga Trusti. Por, një iniciativë të tillë nuk është duke e përkrahur partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 30 MARS** - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, në të cilën përfaqësues të Fondit të Kursimeve Pensionale kanë raportuar lidhur me zhvillimet e fundit në tregjet financiare, ndikimin e tyre në kursimet e qytetarëve dhe për propozimin për tërheqje të mjeteve nga Fondi i Kursimeve.

Kryesuesi i Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, Ruzhdi Morina, ka thënë se kriza në Ukrainë ka ndikuar

menjëherë në tregjet ndërkombëtare financiare, që rrjedhimisht ka prekur edhe Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Sipas Morinës, pas rënies së vlerës së investimeve në muajin shkurt prej 4-përqindësh, ose 90 milionë euro në Fondin e Kursimeve Pensionale, në muajin mars gjysma e kësaj humbjeje është zvogëluar në 55 milionë euro, ose 2.4 për qind. “Një pjesë e fondeve është rikuperuar. Në muajt në vijim shpresojmë që kjo të na shpërblehet. Do të jetë një vit sfidues, duke parë ndikimet gjeopolitike në botë”, ka theksuar Morina. Anëtarët e komisionit shtruan pyetje për drejtuesit e

Fondit për Kursime Pensionale, me theks të veçantë për propozimin për tërheqje të mjeteve nga Fondi i Kursimeve. Në lidhje me këtë pyetje kryesuesi Morina ka thënë se kjo është kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe se ata si institucion do ta përkrahin çdo vendim që sjell Kuvendi. “Ne vazhdojmë ta mbajmë pozicionin se nuk dëshirojmë të përfshihemi në këto iniciativa. Kjo është kompetencë e Kuvendit të Kosovës. Jemi të gatshëm ta zbatojmë secilin vendim që e sjell Kuvendi”, ka thënë Morina. Partia Demokratike e Kosovës (PDK), si partia më e madhe

opozitare, ka propozuar tërheqjen deri në 30 për qind të kursimeve pensionale.

Deputeti i kësaj partie, Bekim Haxhiu, në emër të grupit parlamentar të PDK-së, më 9 mars ka dorëzuar në Kuvend Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Fondin e Kursimeve Pensionale, i cili do ta mundësonte tërheqjen e këtyre mjeteve.

Sipas propozimit të PDK-së, kontributpaguesit që kanë më pak se 10 mijë euro kursime pensionale kërkohet që të kenë të drejtën e tërheqjes së 30 për qind të mjeteve. Ata që kanë deri 20 mijë euro - 25 për qind, nga 20 mijë deri 30 mijë - 20 për qind.

Për kontributpaguesit që kanë kursime pensionale në shumën prej 30 mijë eurosh - 15 për qind dhe ata mbi 40 mijë euro - 10 për qind të shumës.

Deputeti Haxhiu ka thënë se në lidhje me këtë çështje po presin një përgjigje nga Qeveria e

Kosovës. “Qeveria ka fat 30 ditë për të na dhënë një përgjigje dhe në rast se nuk ka ndonjë mendim nga Qeveria e Kosovës, atëherë pas 30 ditësh mund të votohet ose të kalohet në Kuvend Plotësimndryshimi i Ligjit për Trustin, që do t'i hapte rrugë tërheqjes së mjeteve nga ana e qytetarëve. Kam folur me të gjithë deputetët e partive individualisht. Shumica prej tyre janë pro tërheqjes së mjeteve nga Trusti meqë edhe ata kanë çdo ditë kërkesa nga qytetarët e Kosovës që një ide e tillë të shtyhet përpara. Në shumicë janë pro votimit, pro kërkesës, sepse edhe ata sikurse unë, janë kontaktuar nga qytetarët. Unë jam i bindur që kjo iniciativë do të procedohet, sepse deputetët do të veprojnë konform detyrave dhe përgjegjësisë që kanë. Interesat e qytetarëve dhe kërkesa e tyre është që të votohet mundësia për tërheqjen e mjeteve nga Trusti. Jam i bindur që deputetët do të votojnë me

integritet dhe nuk do të bien nën ndikime politike”, ka thënë Haxhiu.

Edhe shefi i grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se logjika e Trustit është kursim personal nga të hyrat e qytetarëve, prandaj si parti ai ka theksuar se vlerësojnë se është e drejtë qytetare përvetësimi i këtyre mjeteve në kohë krize. “U bëj thirrje deputetëve që ta mbështesin ligjin që u mundëson qytetarëve tërheqjen e 30 për qind të shumës së trustit. Nuk duhet që në gjendje të jashtëzakonshme të sillemi zakonshëm!”, ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në “Facebook”. Ish-kryeministri i Kosovës, njëherësh deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, në një deklaratë për “Demokracia.com” ka thënë se është shprehur pro tërheqjes së një shume të kursimeve pensionale, por jo shumës prej 30-përqindësh sa është propozuar nga deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Bekim Haxhiu. “Nuk duhet hedhur poshtë edhe propozimi për tërheqje të një shume të kursimeve pensionale, por një shume më të vogël sesa ajo që është propozuar me qëllim të

ruajtjes së stabilitetit afatgjatë të kursimeve për sigurinë e të ardhurave për pensionistët e ardhshëm”, ka thënë Hoti.

Ndërkaq kryetari i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Armend Muja, ka kundërshtuar kërkesën për tërheqjen e 30 për qind të kursimeve nga Trusti. Ai ka thënë se nuk duhet të bëhet shprehur tërheqja e shpeshtë e mjeteve nga Trusti. “Unë nuk isha privilegjuar sa i përket tërheqjes, nuk është çështja a ka mundësi apo s’ka. Ne nuk themi që qytetarët nuk kanë nevojë, por unë pajtohem me ju që duhet të eksplorojmë mënyra të tjera”, ka thënë Muja.

Qytetarët në Kosovë janë goditur nga një rritje e lartë e çmimeve të konsumit.

Çmimet janë në trend të rritjes për shkak të krizës në tregje që ka shkaktuar pushtimi rus i Ukrainës. Një tërheqje e kursimeve nga Trusti deri në 10 për qind është bërë në vitin 2020, pas përkeqësimit të gjendjes financiare të familjeve për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi. Tërheqja e 10-përqindëshit të kursimeve pensionale ishte bërë në kohën kur qeveria udhëhoq nga Avdullah Hoti.



## NATO-ja hap në vitin 2023 bazën e rinovuar ajrore të Kuçovës

**PRISHTINË, 30 MARS** - Baza ajrore e Shqipërisë e erës komuniste pritet të kthehet në një stacion taktik për operacionet e NATO-s kur ajo të rihapet në vitin 2023. Shpenzimet ushtarake janë tani në rritje në pjesën më të madhe të Evropës, sidomos në Gjermani, por edhe në vendet e Ballkanit. Tensionet janë në rritje edhe afër Shqipërisë. Kroacia, e cila është vend anëtar i NATO-s dhe Serbia që kundërshton aleancën, duket se janë në një garë të vogël ushtarake. Serbia po rinovon aeroplanët MiG-29, tanket dhe sistemin anti-raketë nga Rusia, kurse Kroacia ka blerë 12 avionë luftarakë ‘Rafale’ nga Franca. Puna për modernizimin e bazës ajrore të Kuçovës ka nisur në janar. Qëllimi është që të kthehet në një qendër operacioni për t’i pritur avionët modernë luftarakë. NATO dhe Shqipëria do të investojnë 50 milionë euro për këtë qendër që ndodhet 85 km në jug të Tiranës.

Qyteza e vogël u quajt ‘Qyteti Stalin’ gjatë periudhës komuniste në Shqipëri.

Baza ajrore u ndërtua në vitet 1950 duke përdorur të burgosurit si punëtorë.

Enver Hoxha, ndonëse ishte komunist, ai ishte armiqësor me Bashkimin Sovjetik, Kinën dhe Jugosllavinë pas Luftës së Dytë Botërore, duke e kthyer Shqipërinë në një shtet të izoluar.

Gjatë asaj periudhë Shqipëria quhej gjerësisht si ‘Koreja e Veriut e Evropës’.

Viktor Vangjeli, 83 vjeç, ka shërbyer për 27 vjet në Kuçovë si pilot për avionët MiG-19. Ai tregon për gazetarin e ‘Euronews’, Daniel Bellamy, se kryente fluturime çdo ditë për t’iu kundërpërgjigjur shkeljes së hapësirës ajrore nga fqinjët gjatë Luftës së Ftohtë. “Fluturimet ishin shumë intensive gjatë Luftës së Ftohtë”, tregon ai duke shtuar se deri në 1962 mbulonte të gjithë hapësirën ajrore të vendit. Sipas tij,

modernizimi i bazës do të sjellë përfitime për gjeneratën e re të pilotëve shqiptarë pasi do të kenë mundësi të trajnohen me avionë modernë.

Pas rrëzimit të regjimit komunist më 1990, ushtria shqiptare kishte më shumë se 200 avionë - shumica të modelit MiG - në tri baza të saj ajrore.

Shumica e tyre tashmë janë për skrap pasi në vitin 2005 u vendos që të ndalohej fluturimi i avionëve të vjetër rusë dhe kinezë. Për disa vjet avionët ‘Antonov AN-2’, të periudhës sovjetike me një motor, u përdor për agrokulturë.

Forca Ajrore shqiptare ka tani disa helikopterë - shumica ‘Bells’ dhe ‘Eurocopters’ dhe pritet të marrë disa të rinj ‘Blackhawk’, por jo avionë luftarakë.

Shqipëria, anëtare e NATO-s që prej 2009-s, shpreson të bëhet pjesë e BE-së. Ajo u është bashkuar sanksioneve të BE-së ndaj Rusisë dhe ka denoncuar fort agresionin e Kremlinit. (Euronews Albania)



## Përkujtohen dëshmorët dhe martirët e fshatit Opterushë

**RAHOVEC, 30 MARS (ER)** - Në fshatin Opterushë të komunës së Rahovecit janë përkujtuar të mërkurën dëshmorët dhe martirët e këtij fshati. Në tubimin përkujtimor ka marrë pjesë kryetari i komunës së Rahovecit Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, familjarë të të rënëve dhe përfaqësues të OVL-së. “Me familjarë, bashkëluftëtarë, bashkëpunëtorë dhe

përfaqësues të OVL-së, me përulje përkujtuam dëshmorët dhe martirët e lirisë nga Opterusha. Gjaku i të rënëve u bë themel i lirisë së Kosovës dhe na bën dritë për të ecur pandalshëm drejt përparimit dhe forcimit tonë si popull dhe si shtet. Lavdi dhe respekt i përjetshëm për të gjithë ata që u flijuan për lirinë e kësaj toke!”, ka thënë kryetari Latifi.

## Mbi 500 raste aktive me Covid dhe 30 raste të reja

**PRISHTINË, 30 MARS (ER)** - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të mërkurën se pas 1 159 testimeve, 30 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të mërkurën janë shëruar 31 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 715.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 592.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 278 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 821 818 doza të vaksinës. Deri më sot 820 271 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.



Deri më sot janë dhënë 99 961 doza të vaksinës kundër Covid-19.

treta të vaksinës kundër Covid-19.

HISTORIOGRAFI

# Gjatë Luftës së Dytë Botërore kufijtë politikë u barazuan me ata etnikë (2)

*Kufijtë veriorë të Shqipërisë 1942-1944 sipas burimeve diplomatike angleze*



Nga Dr. Haqif MULLIQI dhe Dr. Daut DAUTI

Krijimi i një Shqipërie të fortë dhe të pavarur nga këto dy shtete fqinje shihet si rrezik i drejtpërdrejtë për to. Një Shqipëri e dobët, konsideronin udhëheqësit e këtyre shteteve, do ta tërhiqte vëmendjen e shteteve e ndonjë fuqie të madhe, apo më shumë syresh të cilat mund të paraqiten edhe si mbrojtëse të interesave të saj. Këto, përpos aspiratave territoriale ndaj Shqipërisë, ishin arsye të tjera, të forta, që i cytnin Greqinë dhe Jugosllavinë të angazhoheshin kundër çfarëdo forme të ekzistimit të këtij vendi.

Nga ana tjetër, Italia përshkruhej si shtet politika e të cilit në mënyrë të veçantë ishte çdo herë e orientuar nga Shqipëria. Gjithashtu, bëhej me dije për rrezikun nga komunizmi rus i cili me permanencë orvatej të gjejë ndonjë dalje strategjike në Adriatik. Por, mbi të gjitha, në këto elabore të ekspertëve britanikë theksohej se “dëshira e shqiptarëve është integruese, pra për një shtet etnik, përkundër dallimeve dezintegruese që janë prezentë në mesin e tyre”, me ç’rast apostrofohej veçanërisht religjioni si faktor dezintegrues.

4. Nga fundi i vitit 1943 në Shqipëri arrijnë tre oficerë të BLO-së (Oficerë Britanik të Ndërlidhjes). Këta ishin majori Billi Meklin, kapiteni Dejvid Samjlli dhe togeri Gari Daf. Gjatë të njëjtit vit dhe gjatë vitit 1944, numri i oficerëve të ndërlidhjes shtohet në vazhdimësi. Madje, njëri ndër këta oficerë, i cili në Shqipëri do të arrijë më vonë, Reginal Hibert, në ditarin e tij të cilin më vonë e shfrytëzoi për botimin e librit të tij “Fitorja e hidhur”, në të cilin, lidhur me çështjen e Kosovës mes të tjerash shkruan: “... Askush nga pala britanike në atë kohë nuk duket të ketë qenë i ndjeshëm për natyrën me thepa të çështjes së Kosovës, madje as ta ketë vështruar si një çështje që duhej marrë parasysh. Në fakt, gjatë luftës ajo do të provohej se do të ishte një çështje themelore, ndërsa ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, një pengesë e madhe për rezistencën

e efektshme kundër gjermanëve, dhe një truall diplomatik i paqëndrueshëm për të gjithë të jashtëm që u përpoqën të luajnë një lojë atje. Në vitet e para të luftës u nënvleftësua nacionalizmi shqiptar dhe domethënia e tij në raport me Jugosllavinë”.

I njëjti, në lidhje me ndjenjat dhe disponimin e shqiptarëve, e në veçanti në lidhje me komunistët, shkruan: “... Brenda Shqipërisë, madje edhe PK-së, të cilën shumica e shqiptarëve jokomunistë e shihnin si dorë të fshehtë të sllavëve dhe që është krijuar me ndihmën e Jugosllavisë, ushqenin shpresën se parimi i vetëvendosjes do të respektohej nga partitë komuniste të Ballkanit dhe se atëherë Kosova do të bashkohet përgjithnjë me Shqipërinë, dhe se të gjithë shqiptarët më në fund do të bashkohen... PKS-h e pa veten të detyruar që më 1943 dhe 1944 të pranojë që parimi i vetëvendosjes nuk do të zbatohet në Kosovë dhe në zonën e Dibrës”.

Siç raportonin oficerët britanikë, në fillim të gushtit (1 dhe 2 gusht të vitit 1943) në Mukje u mbajt një mbledhje shumë me rëndësi dhe, siç flasin edhe dokumentet, madje fshehtas edhe nga këta oficerë. Në këtë mbledhje krerët shqiptarë kanë rënë në dakord që të formohej një komitet për shpëtimin e Shqipërisë në të cilin Nacionalçlirimtarja dhe Balli Kombëtar do të përfaqësoheshin së bashku. Përfaqësuesit e Nacionalçlirimtares u pajtuan gati plotësisht me propozimin e Ballit Kombëtar se duhet bërë një luftë për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë etnike, por evidentohet se Nacionalçlirimtarja kishte një propozim që, natyrisht pas përfundimit të luftës, të organizohej plebishiti për Kosovën. Por, sikur u pa më vonë, për një vendim të tillë NÇ-ja u qortua rreptë nga ana e komunistëve jugosllavë dhe së shpejti Komiteti qendror i PKS-hë hodhi poshtë këtë vendim që doli nga ajo e cila më vonë njihet

me emrin Marrëveshja e Mukjes, e madje u urdhërua që të ndërpritet çdo bashkëpunim me Ballin Kombëtar. Oficerët britanikë 8 gushtin e konsideronin si datë të fillimit të luftës qytetare të Shqipërisë, pra luftës ndërmjet shqiptarëve komunistë dhe atyre nacionalistë, apo, siç e shprehnin ata edhe ndryshe, ndërmjet jugut dhe veriut.

Oficerët në fjalë, përpos ndërlidhjes që bënin ndërmjet forcave të cilat luftonin kundër okupatorit dhe shtabit aleat, gjejeisist Ministria e Luftës e Britanisë së Madhe, filluan të interesoheshin edhe për kufijtë brenda të cilëve gjendej Shqipëria. Oficerët britanikë, zakonisht për mungesë të hartave dhe të statistikës së banorëve të “territoreve të aneksuara”- siç i

quanin ata këto toka shqiptare. Në bazë të të dhënave që u ishin ofruar, ata kishin hartuar ca harta që do t’u hynin në shërbim gjatë punës së tyre. Sipas atyre hartave, numri i banorëve në ato terriore sillej diku prej 500.000 deri në 1.000.000 banorë. Porse, gjithsesi, e kishin parasysh se edhe me këtë rast një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve kishte ngelur edhe jashtë kufijve që ishin formuar gjatë luftës. Me këtë oficerët kishin parasysh territorin e Shkupit, Kumanovës, Preshevës, Bujanocit, terriore këto që i mbante nën okupim Bullgaria. Në arkivin e Ministrisë Britanike të Luftës, në Londër, ruhet e përkthyer në tërësi vepra e Hamit Kokalarit “History of Kosova”, e cila në shqip qe botuar nën titullin “Kosova djep i shqiptarizmit” si antitezë e

suksesshme e asaj “Kosova djep i serbizimit”, në të cilën në mënyrë të denjë dhe të drejtë bëhet fjalë për kufijtë etnikë të Shqipërisë. Më 1941 ndarja e kufijve të Shqipërisë u bë ashtu që kësaj iu shtuan disa rrethe (Baseni i Drinit të Zi, nga Dibra deri në Liqenin e Ohrit, ku përfshihej Struga, Lugina e Epërme e Vardarit deri te Tetova, Rafshi i Dukagjinit me hapësirën në Lindje të Prishtinës deri në Vrajë, afërsisht deri në veri të Vushtrisë, regjioni i Plavës dhe Gusisë, një pjesë jo aq e madhe e Fushës së Podgoricës dhe regjioni i Ulqinit me pjesën e Adriatikut). Ky revizionim i kufijve, të thuash i kënaqi kërkesat e shqiptarëve, pra ato kërkesa të cilat këta i kishin parashtruar që më 1919, përveç disave që kishin të bënin me pjesën veriore të liqenit të Shkodrës dhe liqenit të Ohrit me



Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore

rethinë. Kjo gjithashtu bëri një drejtësi të përafërme nga aspekti etnik, përpos asaj shtrirjes të Shqipërisë në verilindje të vijes Prishtinë-Shkup e cila ndoshta nuk kënaqi në këtë drejtim.

Sipas raporteve të oficerëve britanikë, në pjesët veriore të Shqipërisë dominonin nacionalistët, andaj dhe lëvizjet komuniste dhe prokomuniste nuk kishin ndonjë sukses të hetueshëm siç kishin në pjesët jugore të vendit. Meklin dhe Emeri (autor i librit "Bijt e Shqipësisë") u dërguan pikërisht në veri të Shqipërisë, me qëllim që t'i nxitnin kreun nacionalist dhe bajraktarët që të angazhoheshin në luftë kundër okupatorit. Në një raport të hartuar nga Dejvid Smajli bëhej me dije për shtimin e rezistencës që ishte bërë në Shqipëri gjatë vitit 1943 gjë që paraqitej sukses i drejtpërdrejtë i formimit të LNÇ-së në Konferencën e Pezës një vit më parë (1942), si dhe formimit të Ballit Kombëtar i cili si parullë kishte "Shqipërinë-shqiptarëve", si dhe paraqitej hyrja e gjermanëve në Shqipëri pas kapitullimit të Italisë. Gjithashtu, paraqitej edhe largimi i nacionalistëve nga Këshilli i LNÇ-së me ç'rast përjashtim bënin Abas Kupi, Myslim Peza dhe Babë Faja. Por më vonë largohet edhe Abas Kupi i cili në vjeshtë të vitit 1943 formon partinë zogiste, si dhe vendimi i LN-së që vije në pah pas tetorit të vitit 1943, me të cilin parashihej eliminimi i Ballit Kombëtar.

Në takimet që kishte pasur më vonë Xhulien Emeri me Abas Kupin për ta bindur këtë që të luftojë kundër gjermanëve, Kupi, përveç kërkesave të tjera që i kishte parashtruar, ishte edhe ajo që Shqipëria të përfshihej në Kombet e Bashkuara dhe të sigurohej vetëvendosja për Kosovën dhe territoret e jugut të cilat mund t'i pretendonte Greqia. Në lidhje me mosplotësimin e kërkesave të Kupit, sipas dokumenteve, britanikët kishin dronë se udhëheqësi i Partisë Zogiste të Shqipërisë mund të ecte rrugës së Mihajloviqit. Kërkesa të ngjashme kishte edhe Balli Kombëtar.

Gjatë vitit 1943, britanikët filluan t'i qasen më me seriozitet çështjes së Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare që i qenë bashkëgjatur Shqipërisë. Por, duke pasur parasysh gjendjen e përgjithshme dhe aspiratat e popullit shqiptar, ata kishin bërë një hartë që ia dërguan Ministrisë së Luftës në Londër. Pothuaj në çdo dokument Kosova dhe Dibra (me të cilin emër përfshiheshin territoret shqiptare të Maqedonisë) paraqiten si territore të banuara në mënyrë dominante me shqiptarë dhe se kufijtë prezentë pak a shumë janë në raport me kufijtë etnikë. Sipas britanikëve, e tërë ajo që mund të thuhet në lidhje me këta kufij është element i fortë etnografik dhe përcaktim po ashtu i fortë i shqiptarëve, jo vetëm për të ushtruar influencë brenda këtyre kufijve, por edhe për t'i mbrojtur. Çështja e Kosovës ishte e rëndësishme vitale për shqiptarët si

nga pikëpamja etnografike dhe ajo ekonomike, kështu që pas kolapsit italian Shqipërisë iu desh të orientohej nga Kosova për furnizim me drithëra. Duke pasur shumë fakte parasysh, edhe gjermanët njohën kufijtë e mëparshëm. Andaj, ishte fare e qartë se çështja e këtyre territoreve ishte e një rëndësie të jashtëzakonshme dhe kërkonte që vendimet për to të merreshin para se të vinte koha e konferencës së paqes, atëherë, siç ndodhte rëndom, formohej komisioni i kufijve apo edhe caktohej plebishiti. Oficerët britanikë shënonin se palët (shqiptarët dhe jugosllavët) janë thellësisht të interesuar për këto territore dhe se është plotësisht e mundur që të dyja palët të marrin vendime në vete ose me veprim të përcjell me forcë, ose me modus vivendi. Sidoqoftë, oficerët e misionit ushtarak britanik ishin të pajtimit se territoret në fjalë, në situatën e tanishme, gjithsesi duheshin të administroheshin nga shqiptarët dhe se "... do të ishte jopraktike dhe punë jo e mençur që të mënjanohet administrata shqiptare dhe në vend të saj të substituohet ajo jugosllave". Kështu mendohej gjatë gjithë vitit 1944, edhe pse kufijtë e shtetit shqiptar me fqinjët, siç ishin Mali i Zi, Serbia e Bullgaria, ishin të paqartë për arsye se forcat e ndryshme kalonin në territoret e njëra-tjetrës dhe vendosnin pushtet të përkohshëm. Por, për t'u ikur komplikimeve me autoritetet shqiptare, mendohej se Shqipëria duhet të përfshijë edhe Kosovën, por natyrisht pa bërë prej juridikime të vetëvendosjes së kufijve para Konferencës së Paqes.

6.) Gjatë vitit 1944 shënohet një dendësi në marrëdhëniet e partizanëve shqiptarë dhe të atyre jugosllavë, apo në mes të Enver Hoxhës dhe të Titos - siç thonë misionarët anglezë. Nga ana tjetër vërehej një ftohje evidente ndërmjet Nacionalçlirimtarëve dhe misionit ushtarak britanik dhe atij amerikan i cili sapo kishte arritur në Shqipëri. Britanikët lajmëronin se një mision ushtarak jugosllav i përbërë nga 6 anëtarë dhe i kryesuar nga Velimir Stojniq ishte infiltruar në Shqipëri më 29 gusht 1944.

Kjo i shtyri britanikët që me seriozitet t'u qasen marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të asaj periudhe. Në raport të tyre, në mënyrë kronologjike, duke filluar nga viti 1941 u vunë në pah sulmet e pareshtura të serbëve dhe të malazezëve në kufirin verior të Shqipërisë, duke apostrofuar këtu sulmet e dimrit të vitit 1941 që ishin bërë në kufi me Serbinë, gjegjësisht rreth Serbisë, Novi Pazarit dhe Sjenicës. Në janar të vitit 1943 çetnikët e Gjurishiçit dhe Mihajloviçit invaduan në Kosovë duke shkatërruar fshatra dhe duke masakruar popullatën e rrethit të Bihorit dhe të Rozhajës. Shifrat që mbështeten në të dhënat e burimeve shqiptare tregojnë për 4626 të vrarë e të plagosur dhe 200 gra dhe vajza të përdhunuar. Bëhej



e ditur se italianët, duke mos intervenuar, ushqenin edhe më shumë ndjenjën anti-italiane te shqiptarët.

Veprimet e partizanëve të Ballkanit që ishin bërë në fillim të luftës, në Moskë u cilësuan si tejet nationale, kështu që, së andejmi, arriti një direktivë për të gjitha partitë komuniste të këtij gadishulli në jug të Evropës, që t'i shtypin ndjenjat nacionaliste, veçanërisht brenda radhëve të tyre. Sipas britanikëve, kjo ndikoi që në Pezë, në shtator të vitit 1942, të bëhej ndërlihdja e dëndur e marrëdhënieve ndërmjet partive komuniste të Shqipërisë, Greqisë dhe Jugosllavisë. Pas kësaj ngjarjeje, në Kosovë gjatë vitit 1943 u formua një organizatë komuniste e cila i ipte llogari Titos, qëllimi i së cilës ishte t'i shtypte ndjenjat antiserbe ndër shqiptarët e këtushëm të cilët përbënin shumicën absolute në regjion. Në janar të vitit 1944 në Kolgecaj u mbajt një kongres në të cilin morën pjesë 52 delegatë, duke përfshirë këtu edhe serbët dhe malazezët, si dhe dy deputetë të ish-parlamentit jugosllav.

7.) Marrëdhëniet ndërmjet Enver Hoxhës dhe Titos gjatë vitit 1944 morën formën e qartë. Gjatë po këtij viti, Kosova e okupuar nga gjermanët sulmohej nga të gjitha anët. Është e rëndësishme të theksohet se partizanët e Titos e sulmonin Kosovën në bashkëveprim me çetnikët, siç ishte rasti i sulmeve në rrethinën e Gjilanit. Theksohej se lufta që bënin partizanët jugosllavë dhe

çetnikët ishte e motivuar thjeshtë nga qëllimet nacionaliste. Megjithatë, partizanët shqiptarë i besonin komunikatës së Titos, të shpallur më 4 dhjetor të vitit 1943, kur kishte deklaruar se: "... e ardhmja e Kosovës do të vendoset me plebishit dhe kufijtë e Shqipërisë do të rregullohen në favor të Shqipërisë".

Ardhja e misionit ushtarak sovjetik në Shqipëri edhe më shumë i ftoi shpresat e britanikëve për zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet Britanisë së Madhe dhe Shqipërisë. Ambasada e Mbretërisë së Greqisë në Londër, në një telegram të adresuar te Foreign Office, njofton mbi arrijten e ndihmave në Shqipëri nga BRSS-ja dhe Jugosllavia. Sipas grekëve ndihmat që arritën në Durrës, Vlorë, Sarandë dhe Librazhd ishin ndihma në grurë, misër dhe armatim të kalibrave të ndryshëm.

Gjatë fillimit të vitit 1945 brigadieri Hoxhson raportonte se kishte mjaft indikacione që administrata prezentë e Shqipërisë ishte e gatshme t'i bashkohej federatës jugosllave dhe se bëheshin plane për fillimin e mësimin të gjuhës serbokroate nëpër shkollat e Shqipërisë, duke madhëruar personalitetin e Titos. Por, vihej re se shumica e shqiptarëve do të jenë kundër një federate të tillë, ku do të ketë opozitë edhe brenda FNÇ-së, sidomos në pjesët veriore të Shqipërisë ku droja nga sllavët është më e shprehur.

Intervista e Enver Hoxhës dhënë

"Borbës" së Beogradit më 21 prill të vitit 1945 i sqaron të thuash të gjitha enigmat në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Në një telegram tjetër të dërguar më 5 korrik nga Beogradi në Foreign Office, shkurtimisht jepet përgjigja e dr. Ivan Subashiçit në pyetjen e një oficeri britanik në lidhje me federatën shqiptaro-jugosllave. Subashiçi ishte përgjigjur se ende, në disa qarqe të brendshme të të dy partive komuniste, qarkullon një skemë e tillë dhe se ishin duke u zhvilluar disa bisedime të rëndësishme minore, që kishin të bënin me tokat e mbetura në të dy anët e kufirit.

Në një telegram tjetër që mban datën 9 mars 1945, i jepet biseda e brigadierit Hoxhson me Omer Nishanin, i cili mbante pozitën e Ministrit të Jashtëm në administratën e Enver Hoxhës dhe i cili kishte deklaruar se Shqipëria nuk e ka mendjen t'i bashkëngjitet federatës me Jugosllavinë, por, sipas Nishanit, një federatë ballkanike do të ishte e mirëseardhur për shqiptarët.

Ideja për federatën shqiptaro-jugosllave dhe atë ballkanike nuk u realizua për shumë arsye. Idetë e tilla mbetën vetëm në iniciativë dhe si plane të porealizuara. Ndërsa, sa i përket çështjes së kufijve veriorë të Shqipërisë, kjo as që u trajtua në Konferencën e Paqes që u organizua pas mbarimit të luftës. Madje, qeveritarët komunistë shqiptarë u ballafaquan edhe me problemin e pjesëmarrjes në këtë konferencë. (Fund)

# PËR ÇFARË LUFTE NË KOSOVË E KENI FJALËN, O MBURRAVECË!



**Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA**

Kotësia e një parashikimi: Lufta në Ukrainë po vazhdon dhe pasojat e kësaj lufte po dërrmojnë tregjet e botës sidomos shtetet e fuqishme evropiane që kanë krijuar vartësi kronike nga nafta ruse, gazi rus, gruri dhe mielli ukrainas sikur edhe ai i Rosisë. Gjithashtu, vaji i lulediellit është bërë shumë i kërkuar për faktin se Ukraina, Donbasi, Luhanski dhe Krimea që janë nën administrim të Federatës Ruse janë bazenet kryesore botërore të lulediellit. Në Kosovë kjo krizë hetohet më pak për faktin se kemi lindur në krizë, jetojmë në krizë dhe vdesim në krizë, me një fjalë kriza është përmbajtja e jetës dhe përfundimi i jetës. Edhe Buxheti i Kosovës është buxhet simbolik, social që siguron një mbijetesë të padinjitetshme për numrin më të madh të qytetarëve të Kosovës ndërsa projektet zhvillimore, për shkaqe objektive dhe subjektive janë arkivuar..., deri në zgjedhjet e ardhshme. Këto projekte zhvillimore, si Kutia e Pandorës do të hapen gjatë fushatës elektorale. Nëse i kemi parasysh rrethanat në të cilat po qeverisë Qeveria Kurti II siç janë pandemia e shkaktuar nga Covid-19 e që ka bllokuar shumë procese, ka dëmtuar shumë biznese duke krijuar papunësi edhe më të madhe sikur edhe ngritja e çmimeve shkaku i krizës globale e sidomos përshkallëzimi shkaku i luftës në Ukrainë, atëherë Qeveria Kurti II nuk duhet t'i nënshtrohet pushkatimit publik që po i bëhet për faktin se, me këto mundësi buxhetore e sidomos në këto rrethana, nuk e besoj se dikush apo çfarëdo qeverie do të bënte mrekulli përjashtuar ndonjë magjistari që ka kapacitet të

bollshëm hipnotizues për vënie në gjumë të kopesë elektorale. Për herë të parë një lider që sipas parimeve çerçilliane mori pushtetin absolut, kryeministri Kurti, bashkë me koalicionin, përmes fuqisë së madhe të numrave të pushtetit pati mundësi të realizojë premtimet e fushatës aq më parë që thuaja nuk kishte fare opozitë. Më shumë i ka bërë opozitë Albin Kurtit Kimete Berisha me shkrimet e shpeshta, se të gjitha partitë opozitare, PDK, LDK dhe AAK! Jam i sigurt se asnjë parti opozitare, përjashtuar ndoshta AAK-ja, nuk do ta pranonte ta merrte pushtetin në këto rrethana edhe nëse Albin Kurti do t'ua dorëzonte edhe me ceremoni shtetërore! Nuk janë të gatshëm të qeverisin dhe po presin që Albin Kurti të bëjë gabime e gabime e që pastaj, ta provojnë edhe një herë. Opozita i ka bërë llogaritë që Kurti të qeverisë një mandat pastaj nëse lodhet, deri në rraskapitje, të paraqiten si infuzion për ta vazhduar mbijetesën, tani, në rrethana tjera. Opozita po gabon në llogaritë e saja politike duke menduar se Kurti është antiamerikan dhe mbi këto themele ndërtojnë shpresat dhe iluzionet. Vetëm të ne në Kosovë ndodhë që politikanët e nivelit më të lartë të deklarojnë publikisht se do ta pranojnë çdo propozim që vjen nga amerikanët, pa e lexuar fare përmbajtjen! Jam i sigurt se Kurti, gjithashtu do t'i pranojë propozimet por jo pa i lexuar. Pasi t'i ketë lexuar do t'i mbështjellë me një patriotizëm dhe interes shtetëror e që do i qet në tregun politik kosovar si zgjedhje më të mira se ato të 20 vjetëve të mëparshme.

Nostradamusi dhe Baba Vanga kosovare: Pas vazhimit të luftës në Ukrainë, politikanët kosovarë, sidomos pozita parashihnin luftë në Kosovë përkatësisht se Serbia do të ndërhyjë në veri të Kosovës. Realisht, u krijua një situatë se luftë do të ketë 100 për qind por se nuk mund të parashikohej dita, ora dhe minuta e fillimit të luftës. Këta parashikuesit e që janë 1000 herë më të mençur se unë dhe kanë më shumë informata, me vetëdije të plotë manipuluan dhe po manipulojnë me të vërtetën duke e zhvendosur problemin në një fushë tjetër, fushën e luftës e që ngjallë frikë te shumica e qytetarëve. Të gjithë e kanë të qartë se në këto rrethana, edhe nëse Serbia do të donte, në Kosovë nuk do të ketë luftë. Po të ishte Vuçiqi i marrë siç mendojnë dhe dëshirojnë disa politikanë kosovarë, nuk do të shndërrohej në njeri të besueshëm të amerikanëve, evropianëve dhe atyre që vranë e kthjellin në botë. Pastaj, e ka përkrahjen e plotë të Rosisë dhe Kinës që e shndërron në kryetar të Ballkanit të Hapur. Bashkësia ndërkombëtare e konsideron lojtar të pazëvendësueshëm në Ballkan ndërsa nuk refuzon asnjë propozim për bisedime me Kosovën duke u shtirë se është në gjendje që në çdo çast të sakrifkohet dhe vdes për ruajtje të paqes! Po kjo bashkësi ndërkombëtare e ka lënë Serbinë pa opozitë vepruese sikur edhe në Kosovë. Tash, Vuçiqi fiton zgjedhjet në Serbi me më shumë se 50 për qind dhe është irelevante se ku do te votojnë serbët e Kosovës. Biseksualiteti i deklarimit politik për Ukrainën ku vetëm brekët ua tregoi bashkësisë ndërkombëtare

ndërsa kurvërinë politike me Rusinë e ka Kushtetutë morale, politike, njerëzore dhe shtetërore, jo që nuk e dobësoi politikisht por ia rriti peshën specifike politike në kohën kur Nostradamusi kosovar dhe Baba Vanga kosovare përrallisnin për luftën në Kosovë në kohën kur nuk ka rezerva shtetërore as për 72 orë të plota. Kur Neroni kërkoi nga Seneka një fjalim filozofik, përgjigja ishte: "së pari ma mbushë barkun pastaj merremi ne filozofi...". Albin Kurti dhe Vjosa Osmani duhet ta largojnë retorikën që afirmon luftën sepse askush nuk i pyet për asgjë. Duhet t'i kthehen problemeve reale që mund të zgjidhen, pavarësisht situatës jo të mirë. Duhet të tregojnë më shumë respekt për opozitën, sado e lodhtë që është. Pa opozitën nuk do të kalojë Marrëveshja me Serbinë, këtë e kanë të qartë edhe ndërkombëtarët. Në rrethanat e krijuara opozita duhet të sillet në pajtim me interesin shtetëror dhe të përkrah ndalimin e hapjes së qendrave të votimit të Serbisë në Kosovë, me ndrikullën OSBE. Nuk ka Marrëveshje me Serbinë pa pajtimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e që po mbahet peng në Hagë. Kush e shkelë luftën, e humbë paqen dhe është pa ardhmëri. Për Ukrainën më shumë po brengoset presidentja e Kosovës se vet Zielinski, kryetari i Ukrainës. Më shumë po bënë analiza për ndikimin dhe rrezikun rus në Ballkan dhe Kosovë, se tërë Pakti NATO, me Stoltenbergun. Të vetmit që mund të shtyhen me kryeministrin dhe presidenten në kualifikimin e personalitetit të Putinit, deri diku po e them,

janë Bajdeni dhe Blinken! Albin Kurti, si kryeministër me fuqi absolute vendimmarrëse në Kosovë duhet të thërrasë urgjentisht opozitën sepse pas zgjedhjeve në Serbi dhe zhvillimeve në Ukrainë, do të këndohet një këngë tjetër. Serbia është faktorizuar shumë ndërkombëtarisht dhe lojën po e bënë në territorin e Kosovës, pa e prekur fare Serbinë. Nëse aq shumë po flasin për rrezikun e luftës në Kosovë, kryeministri Kurti dhe presidentja Osmani duhet ta kanë të qartë se koalicioni qeverisës ka shumë pak ushtarë që do ta bënin luftën. Po, ta lëmë luftën sepse diçka të tillë nuk do të ndodhë në Kosovë për aq sa Vuçiqi po luan me dy palë letra, e para ka dhënë garanci se nuk do të ndërhyjë në Republika Srpska dhe, e dyta, po nga kjo bashkësi ndërkombëtare e ka të garantuar pjesën e tortës në Kosovë përmes Marrëveshjes përfundimtare me Kosovën për të cilën të gjithë ndërkombëtarët deklarojnë se do të ketë kompromise të dhimbshme. Nëse edhe më tutje do të merremi vetëm me Ukrainën dhe Rusinë e që për këtë nuk po kanë kapacitetet as shtetet më të fuqishme të botës, kompromiset e dhimbshme do të shndërrohen në makt dhe, në këtë rast vërtetë mund të ketë luftë të re. Të merremi me pordhët tona e mos të merremi me rrezikun që paraqet armatimi nuklear i Rosisë. Të parat mund dhe i dëgjojmë çdo ditë, për të dytat vetëm mund të përrallisim, urbi et orbi. Kush po na pyet dhe kush na merr seriozisht kur jemi aq të padijshëm dhe aq joseriozë. Zoti qoftë me në prag të Muajit të Madhërishtë të Ramazanit.



# Projektligji për Paga, rrezik nga shpërthimi i pakënaqësive sociale



**PRISHTINË, 30 MARS** - Kosova rrezikon të përfshihet nga pakënaqësitë sociale për shkak të Projektligjit për Paga. Sindikalistët të sektorëve të ndryshëm publikë kanë paralajmëruar protesta dhe greva si formë presioni për miratimin sa më të shpejtë të këtij projektligji.

Ligji i Pagave është miratuar një herë në shkurt të vitit 2019 dhe ka hyrë në fuqi në muajin pasues. Por, një muaj para se të niste zbatimin i tij, në janar të 2020-s, institucioni i Avokatit të Popullit e ka dërguar atë në Gjykatën Kushtetuese për, siç ka thënë, “vlerësimin e përputhshmërisë” së tij me Kushtetutën e Kosovës. Gjykata më pas ka konstatuar se ligji i miratuar nuk është në përputhje me 11 nene të Kushtetutës dhe se shkakton “çrregullim të ndarjes së pushteteve në disfavor të gjyqësorit dhe institucioneve të pavarura”.

Ligji është shfuqizuar dhe që nga ajo kohë ka mbetur pezull, kryesisht për shkak të zhvillimeve politike që kanë përfshirë disa

palë zgjedhje në vend.

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës kanë thënë për “Radion Evropa e Lirë” se projektligji tani është në fazën e fundit të rihartimit dhe se miratimi nga ta pritet të bëhet muajin e ardhshëm. Ata, po ashtu, kanë premtuar konsultime publike për të.

Pas miratimit në qeveri ligji duhet të kalojë në Kuvend, të nënshkruhet nga presidentja dhe të dalë në gazetën zyrtare. Projektligji për Paga parasheh rritje të pagave në bazë të koeficientit, apo detyrave që kanë punonjësit publikë.

Deri në miratimin dhe fillimin e zbatimit të tij, sindikata të ndryshme kanë kërkuar nga qeveria që të ndajë mjete shtesë, krahas pagave mujore. Sipas tyre, ato janë të domosdoshme për shkak të rritjes së inflacionit. Muajin e kaluar inflacioni në Kosovë ka arritur në 7.5 për qind, krahasuar me 0.7 për qind sa ka qenë në shkurt të vitit 2021.

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka paralajmëruar protestë në

Prishtinë më 8 prill nëse Qeveria e Kosovës, sipas tij, nuk bën zgjidhje për Projektligjin e Pagave. Sindikata e Shëndetësisë ka thënë se më 7 prill do të vendosë për “veprime sindikale”. Sindikata e Arsimit ka thënë se do të presë një takim me zyrtarë të qeverisë deri më 2 prill, në të kundërtën do të futet në grevë.

Sindikata e stafit administrativ në sistemin e drejtësisë ka thënë se i jep afat ekzekutiv deri në gjashtë muaj; nëse Projektligji për Paga nuk i përmbush kërkesat e saj për rritje pagash, edhe kjo sindikatë mund të ngrihet me shprehje të pakënaqësive.

## Sindikatat: Qeveria nuk është transparente

Blerim Syla, kryetar i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se pakënaqësitë e punëtorëve janë rritur, pasi zyrtarë të qeverisë janë zotuar se Projektligji për Paga do të miratohet nga ta në muajin mars.

“Ne jemi të pakënaqur me pagat, mirëpo i kemi dhënë mundësi dialogut. Dialog nuk ka. Atëherë, mjet i fundit është reagimi sindikal. Nuk kemi pasur takim me zyrtarë të qeverisë. Ata kanë premtuar, por vetëm një mbledhje simbolike është mbajtur. Gjithçka është duke shkuar në mënyrë jotransparente”, thotë Syla.

Grevën e fundit njëditore Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës e ka mbajtur më 25 nëntor të vitit 2021, pikërisht me kërkesën për rritje pagash.

Paga e mjekut specialist në Kosovë aktualisht është 600 euro; me ligjin e shfuqizuar do të ishte 1 195.00 euro. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rrahman Jasharaj, thotë se institucionet nuk kanë dhënë informacione se në cilën fazë të hartimit është projektligji për paga.

“Pakënaqësia më e madhe është se përse qeveria po i mbyll dyert dhe po i ik dialogut me SBASHK-un dhe sindikatat e tjera. Ky

dialog po mungon dhe kjo po krijon tensione shtesë, sepse ne nuk po kemi përgjigje zyrtare për shumë çështje”, thotë Jasharaj për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, SBASHK-u kërkon nga autoritetet përgjegjëse që të ndajnë mjete shtesë - 100 euro në muaj - për të gjithë të punësuarit në sistemin e arsimit dhe kulturës derisa të fuqizohet Projektligji për Paga dhe të nisë së zbatuari.

Ligji i shfuqizuar ka paraparë rritjen e pagës së një mësimitdhënësi të shkollës fillore nga 470 euro në 612 euro; të një arsimtari të shkollës së mesme nga 525 në 621 euro, dhe të asistentëve dhe profesorëve universitarë nga 1 070 në mbi 1 338 euro. Punëtorët e administratave të gjykatave dhe prokurorive kanë qenë në grevë nga data 1 deri më 18 mars, duke kërkuar rritje të pagave.

Kryetari i Shoqatës Sindikale në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Naim Rustemi, thotë se kërkesë kryesore e tyre ka qenë që në kuadër të Projektligjit të pagave, pagat e punëtorëve të administratës të përafrohohen me ato të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sipas tij, paga mesatare e stafit administrativ është rreth 400 euro në muaj, kurse e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga 1 800 deri në 2 700 euro.

Derisa të nisë së zbatuari Ligji për Paga, Rustemi thotë se sindikata që udhëheq ai kërkon 150 euro shtesë në muaj për çdo punëtor të administratës, si dhe pagesën e shujtës ditore dhe të udhëtimit. Rustemi thotë se greva është pezulluar për t'i dhënë kohë qeverisë deri në gjashtë muaj për përmbushjen e kërkesave të sindikatës së tij. “Nëse eventualisht jemi të pakënaqur me Projektligjin e Pagave atëherë mjet i fundit është greva, sepse greva është pezulluar dhe nuk është ndërprerë”, thotë Rustemi për “Radion Evropa e Lirë”.

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës kanë thënë se konsultimet publike për Projektligjin e Pagave do të fillojnë gjatë marsit, kur do të jenë të ftuara të gjitha sindikatat, mediet dhe shoqëria civile. Megjithatë, deri me datën 30 të këtij muaji nuk ka pasur njoftim për ndonjë debat të tillë.

## Shpërndahen 400 pako ushqimore për familjet në nevojë

**PODUJEVË, 30 MARS (ER)** - Organizata “Qatar Charity” ka dhuruar 400 pako ushqimore për familjet në nevojë në komunën e Podujevës. Ky donacion buron pas marrëveshjes së nënshkruar ditë më parë nga kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, me

përfaqësues të Organizatës “Qatar Charity”. Bulliqi ka thënë se ndihet i lumtur që në prag të muajit të shenjtë të Ramazanit po arrijnë t'i ndihmojnë familjet me gjendje jo të mirë ekonomike.

Kryetari Bulliqi me këtë rast ka falënderuar organizatën për donacionin e dhuruar si dhe

mirëprelet të gjithë donatorët që kontribuojnë që në këtë muaj të madhërisëm që sofrat e këtyre familjeve të jenë plot.

Vlera e projektit është mbi 21 mijë euro, ndërsa për zbatimin e projektit, sipas memorandumit të nënshkruar, u përkujdes Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS).



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Envert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
 TEL: 045/82 82 82

## Prizreni 16 dhe Teuta fitojnë sfidat e para çerekfinale

**RAHOVEC, 30 MARS** - Prizreni 16 dhe Teuta kanë fituar ndeshjet e para çerekfinale të "play-off"-it në Ligën Unike të meshkujve. Skuadrat që janë më të mira nga dy ndeshjet, kualifikohen në gjysmëfinale, ku janë kualifikuar direkt Golden Eagle Ylli dhe Peja. Përballje shumë interesante u zhvillua mes Rahovecit dhe Prizrenit 16, ku fituan prizrenasit me rezultat 93:98 (28:22, 23:20, 22:27, 20:29). Çereku i parë ishte interesant dhe i barabartë deri tek rezultati 19:22, ku vendasit me një seri prej 9:0, duke e fituar këtë pjesë 28:22. Në periudhën e dytë, e shtuan edhe më

shumë epërsinë, duke shkuar në pushim me shifrat 51:42. Tifozët patën mundësi të shohin një përballje të barabartë, si dhe me shumë aksione të bukura, kurse në dhjetë minutat e fundit dhe atë vendimtare, prizrenasit ishin më të mirë dhe përqendruar, duke fituar me pesë pikë dallim, 93:98. Te Rahoveci u dalluan TJ Dunans me 24 pikë, 17 kërcime e gjashtë asistime dhe Musab Mala me 22 pikë, shtatë kërcime e gjashtë asistime, ndërsa te Prizreni 16 u dalluan Darell Davis me 23 pikë, 12 kërcime dhe nëntë asistime, Arti Hajdari me 27 pikë dhe



Roy McCoy me 20 pikë e 10 kërcime. Teuta ka shënuar fitore ndaj Tirana Neptun me

rezultat 96:81 (29:23, 21:24, 24:18, 22:16). Pjesa e parë e sfidës ishte e barabartë, ku

durrësakët çerekun e parë e fituan 29:23, ndërsa kundërpërgjigja e tiranasve erdhi në periudhën e dytë që e fituan 21:24, duke shkuar në pushim me rezultat 50:47. Megjithatë, në pjesën e dytë, vendasit ishin më të mirë, duke e fituar sfidën e parë me rezultat 96:81. Te Teuta u dalluan Tyler Peterson me 22 pikë, shtatë kërcime dhe gjashtë asistime, Frenki Lilaj me 21 pikë e tetë kërcime dhe Nazar Core me 24 pikë, pesë kërcime dhe gjashtë asistime, kurse te Tirana Neptun u dalluan Endrit Hysenagolli me 17 pikë e 13 kërcime dhe Julian Hamati me 20 pikë.

## Bashkimi dhe Prishtina fitojnë gjysmëfinalen e para

**PEJË, 30 MARS** - Bashkimi ka shënuar fitore ndaj Penzës në udhëtim me rezultat 61:76 (21:21, 9:15, 21:14, 10:26), në ndeshjen e parë gjysmëfinale të "play-off"-it në Superligën e Femrave. Ndeshja e dytë zhvillohet në Prizren, ndërsa skuadra që shënon dy fitore kualifikohet në finale. Çereku i parë ishte tërësisht i barabartë, ku shumë herë u barazua rezultati dhe asnjëra skuadër nuk arrinte shkëputjen, duke përfunduar 21:21. Edhe periudha e dytë ishte e barabartë deri tek rezultati 30:27, ku mysafiret hyn në një seri të suksesshme, duke shkuar në pushim me



shifrat 30:36, ndërsa vendasit për rreth pesë minuta nuk shënuan pikë. Pejanet u rikthyen në periodën e dytë, duke shkruar epërsinë e mysafireve, ku u zhvillua një

lojë interesante, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 51:50. Deri në katër minutat e fundit u zhvillua lojë e barabartë, ku më pas prizrenasit ishin shumë më të mira në momentet vendimtare dhe triumfuan me rezultat 61:76. Te Penza u dallua Rael Whitsitt me 11 pikë e 15 kërcime dhe Valbona Bytyqi me 17 pikë e nëntë kërcime, kurse te Bashkimi u dalluan Besjana Martinaj me 24 pikë e pesë kërcime, Era Shatri me 19 pikë e 10 kërcime dhe Monique Coker me 11 pikë e 17 kërcime. Ndërsa Prishtina ka shënuar fitore ndaj Trepçës

në gjysmëfinalen e parë të "play-off"-it me rezultat 76:64 (19:7, 16:14, 21:19, 20:24). Ndeshja e dytë zhvillohet në Mitrovicë, ndërsa skuadra që shënon dy fitore do të kualifikohet në finale. Skuadra prishtinase e nisi ndeshjen shumë më mirë me një seri prej 13:2 dhe gjatë gjithë çerekut të parë ishte në epërsi, duke e fituar këtë pjesë 19:7. Periudha e dytë ishte më e barabartë në krahasim me të parën. Prishtinasit arritën epërsi deri në 17 pikë, 31:14, ndërsa pjesa e parë përfundoi 35:21. Edhe periudha e tretë ishte e ngjashme me atë të dytën, ku vendasit për dy pikë

ishin më të mira, 21:19. Ato arritën epërsi deri në 18 pikë, 46:28, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 56:40. Në dhjetë minutat e fundit, mitrovicaset u afruan në vetëm pesë pikë, 58:53, por pa arritur të bëjnë më shumë dhe kryeqytetasit triumfuan 76:64. Te Prishtina u dalluan Agnesa Rrahmani me 22 pikë, shtatë kërcime e pesë asistime, Stasha Carey me 16 pikë e dhjetë kërcime dhe Arbnore Përquku me 15 pikë, tetë kërcime e shtatë asistime, ndërsa te Trepça u dalluan Kelly Santos me 14 pikë e 15 kërcime dhe Tasharra Jeffries me 35 pikë e pesë kërcime.



## FFK-ja publikon datat e ndeshjeve të Kosovës për Ligën e Kombeve

**PRISHTINË, 30 MARS** - Federata e Futbollit e Kosovës ka publikuar datat për ndeshjet e radhës të Përfaqësueses së Kosovës në Ligën e Kombeve, të vlefshme për

kualifikim të më tutjeshëm në ligën B. Më 2 qershor Kosova do të luajë me Qipron, me këtë të fundit si nikoqire. Kundër Greqisë, Kosova do të luajë si vendase

më 5 qershor. Më 9 qershor "dardanët" do të përballen me Irlandën Veriore, ndërsa më 12 qershor Kosova do ta zhvillojë ndeshjen kthyesë me Greqinë.

## Khaka, pas ndeshjes së 100 me Zvicrën: U jam mirënjohës të gjithëve

**CYRIH, 30 MARS** - Mesfushori Granit Khaka ka falënderuar të gjithë pas paraqitjes së 100 me kombëtaren e Zvicrës. Khaka e zhvilloi ndeshjen e 100 me Zvicrën ndaj Kosovës, ndeshje e cila përfundoi me rezultat 1-1. "Është një ndjenjë e pabesueshme ta përfaqësosh Zvicrën për herë të 100. Ky vend i

mrekullueshëm ka bërë shumë për veten dhe familjen time - dhe unë gjithmonë përpiqem ta shpërblej mirëpritjen e ngrohtë që na është bërë duke dhënë gjithçka time absolute kur jam në fushë. Ka shumë trajnerë, bashkëlojtarë, tifozë dhe sigurisht anëtarë të familjes që më kanë ndihmuar shumë gjatë rrugës.

Ju jam jashtëzakonisht mirënjohës të gjithëve. Mezi pres për të ardhmen dhe atë që na pret si ekip. Jemi në një rrugë vërtet të mirë dhe do të vazhdojmë të japim gjithçka çdo ditë që jemi bashkë sepse kemi shumë kujtime të veçanta për të krijuar", ka shkuar mesfushori Khaka në "Instagram".



## Zbulohet kalendari i Botërorit të Katarit

Doha, 30 mars - Kampionati Botëror këtë vit do të jetë më ndryshe se të tjerët për faktin se Botërori i Katarit do të mbahet në fund të vitit, për dallim nga herët e kaluara, kur evenimenti më i

rëndësishëm i futbollit botëror mbahej gjatë verës. 32 ekipe kombëtare do të ndahen në 8 grupe, prej A deri në H, me nga 4 skuadra. Faza e grupeve e "Katar 2022" do të fillojë më 21

nëntor dhe do të mbyllet më 2 dhjetor. E teta e finales do të luhet në mes të datave 3 dhe 6 dhjetor. Çerekfinalja do të zhvillohet më 9 dhe më 10 dhjetor, kurse gjysmëfinalja më 13 e 14

dhjetor. Ndeshja për vend të tretë dhe të katërt do të luhet më 17 dhjetor, ndërsa finalja e madhe e Botërorit do të zhvillohet më 18 dhjetor, kur edhe do të mbyllet përfundimisht.



## Formacioni me yjet që mungojnë në Kupën e Botës

DOHA, 30 MARS - Lista e skuadrave thuajse është kompletuar kur mbeten edhe tetë muaj nga zhvillimi i Kupës së Botës në Katar. Një nga emrat e mëdhenj që do t'i mungojë këtij kompeticioni është edhe Mohamed Salah. Egjipti i tij nuk ia doli që të siguronte një biletë për në fazën finale, pasi dështuan me penallti ndaj Senegalit. Gjithsesi lista e mungesave është e gjatë, duke filluar nga porta, atje ku nuk do të kemi mundësinë t'i shohim magjitet e Oblak. Në mbrojtje nuk do të jetë legjendari Chiellini, apo Spinazzola që shkëlqeu në Evropian. Në mesfushë spikat mungesa e Jorginhos, ndërkohë që para tij në formacionin e mungesave spikasin Odegaard dhe Mahrez. Në sulm nuk ka asnjë dyshim pasi, përveç Salah, një



mungesë shumë e rëndësishme është dhe ajo e Erling Haaland. Me Norvegjinë e tij ai nuk do të ketë mundësinë që t'i shfaqë vlerat në një kompeticion kaq

prestigjioz. Formacioni (3-5-2): Oblak, Lindelof, Chiellini, Spinazzola, Jorginho, Bissouma, Mahrez, Odegaard, Diaz, Salah, Haaland.

## Milwaukee synon kreun, tjetër zhgënjim për lakesat

PHILADELPHIA, 30 MARS - Milwaukee hedh kandidaturën për ta marrë kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 118-116 arritur në fushën e Philadelphia. Sfidë e ekuilibruar deri në fund, ku për kampionët e Bucksit u dallua Giannis Antetokounmpo me 40 pikë e 14 rebounde. Në kahun tjetër Hardeni realizoi 32 pikë e Embiid 29, por që s'mjaftuan. Tjetër dështim për lakesat, që u mundën me rezultat 128-110 nga Dallasi, ndeshje ku dallimin për teksanët e bëri Luka Donçiq. Ai realizoi një "triple double" me 34 pikë, 12 rebounde e 12 asistime. Fiton edhe Brooklyn



që, falë 31 pikëve të Durantit, mundi me rezultat 107-94 Washington (DeRozan 32 pikë, Vuçević 27 pikë).

### REZULTATET

Philadelphia - Milwaukee	116-118
Washington - Chicago	94-107
Brooklyn - Detroit	130-123
Dallas - Lakers	128-110
Clippers - Utah Jazz	121-115

### SHKURT

#### Ronaldo: Vitet kalojnë, por objektivat mbeten të njëjta

Cristiano Ronaldo do të jetë në Kupën e Botës në Katar. Sulmuesi siguroi një biletë teksa mposhti në finalen e "play-off" Maqedoninë e Veriut me shifrat 2-0. Ronaldo la gjurmë në golin e parë duke e shërbyer Bruno Fernandes. Së fundmi ai ka reaguar me një mesazh në rrjetet sociale, duke shprehur krenarinë për këtë kualifikim duke e lidhur dhe me moshën e tij. "Vitet kalojnë, por objektivat vijojnë të mbeten të njëjta", i referohet dëshirës për të fituar gjithmonë që, në fakt, është edhe në karakterin e tij. Mbetet të shihet nëse do të lërë gjurmë në Katar, teksa mund të sfidojë dhe Messin, që do të jetë me Argentinën.

#### Ancelotti infektohet me Covid

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Klubi madrilen ka njoftuar se trajneri i tyre ka rezultuar pozitiv. "Real Madrid CF njofton se trajneri ynë Carlo Ancelotti ka rezultuar pozitiv me Covid-19", shkruan klubi i Real Madridit. Ndeshja e ardhshme e madrilenëve është ndaj Celta Vigos më 2 prill, ku me shumë gjasë Ancelotti nuk do të jetë në krye të stolit, shkak i infektimit me Covid-19.

#### Interi: Martinezi kushton 68 milionë euro

Skuadra e Interit duket se është e gatshme ta shesë Lautaro Martinezin në afatin kalimtar të kësaj vere. "Nerazzurët" kanë vazhduar kontratat e disa lojtarëve, duke rrezikuar kështu pragun e shpenzimeve, por kjo mund të ulët nëse shesin në afatin e verës. Sipas asaj që raporton "Calciomercato", Martinezi do të jetë lojtari i parë në listën e largimeve nga kampioni i Serisë A-së. Klubi italian tashmë i ka caktuar çmimin lojtarit dhe, sipas mediumit, klubi që i do shërbimet e tij duhet të paguajë 68 milionë euro. Arsenali dhe Atletico Madridit thuhet se kanë shfaqur interesim direkt, por që për të në garë mund të futen edhe Barcelona e Bayern Muncheni.

#### Milani e dëshiron Hazardin

Eden Hazardi mund të përfundojë në Serinë A pas një aventure jo të mirë te Real Madridi. Ylli belg nuk ka plotësuar as gjysmën e pritshmërive që kishin në Real. Gjithsesi, Hazard gëzon ende pëlqim nga disa skuadra të mëdha dhe, sipas 'Sport', një nga to është skuadra e Milanit. Skuadra kuçezi dëshiron transferimin ish-anëtarit të Chelseat në afatin kalimtar të verës.

## Ibra nuk pensionohet nga kombëtarja

Suedia është eliminuar në "play-off" nga Polonia, pasi kjo e fundit fitoi me shifrat 2-0, që do të thotë se nuk do të luajë në "Katar 2022" në nëntor. Nëse Suedia është eliminuar nga botërori nuk mund të thuhet e njëjta gjë

edhe për Zlatan Ibrahimović, i cili, pavarësisht se është në moshën 40-vjeçare, dëshiron të vazhdojë të luajë për sa kohë që mundet. Megjithatë, suedezi nuk duket se po mendon të pensionohet. Kur u pyet nëse do të vazhdonte

të luante, ai u përgjigj pozitivisht. "Përderisa mund të qëndroj i shëndetshëm dhe të luaj dhe të kontribuoj diçka, shpresoj që po. Do të vazhdoj për aq kohë sa të mundem. Nuk do të merrni një përgjigje tjetër nga unë,

vetëm sepse nuk fituam dhe nuk u kualifikuam në Kupën e Botës", ka thënë Ibrahimović për "ANSA". Ibra ka shënuar tetë gola në 22 paraqitje në të gjitha garat këtë sezon. Ai tha javën e kaluar se ideja e daljes në

pension i jep atij një "ndjenjë paniku". Sipas "La Gazzetta dello Sport", Milani mund t'i ofrojë atij një zgjatje të kontratës me ulje rroge dhe Ibra mund të bëhet një nga drejtorët e klubit në fund të karrierës së tij si lojtar.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



**DREJTORIA E ARSIMIT**  
05nr.381 datë 30.03.2022

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.05/2021 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm),UA MASHTnr.08/2021,Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komonale e Arsimit shpall dhe rishpall:

**KONKURS**  
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

- SHFMU "Dëshmorët e Tivarit"-Peqan**
  - Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe
  - Koeficienti: A-421
- SHFMU "Sadri Duhla"-Duhël**
  - Një mësimdhënës/e për lëndët historio-edukative qytetare në Lagjen e Sopës dhe Greqicë(zëvendësim i pushimit të lehonisë)
  - Koeficienti:A-421

**Kushtet:** Për vendet e lira të punës për mësimdhënës/e të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.05/2021 dhe UA-MASHT nr.08/2021.

- SHFMU "Dituria "në Samadraxhë**
  - Një punëtor/e teknik-ndihmës –rishpallje
  - Koeficienti: A-4/1

**Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:**

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës ,duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Minsitria e Arsimit,Shkencës ,Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHTI(nëse ka)


Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.


**Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.**



Drejtori i DKA-së  
Remzi Bajselmani



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



**DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE**  
05 br. 381 od 30.03.2022 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03/L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u republiku Kosova br.04/L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opština Republice Kosovo br.03/L-068,Al br.05/2021(Normariva u stručnim kadrovima opšteg obrazovanja),UA.MONT-a br.08/2021, Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog mesta u javnom sektoru,Opština direkcija za obrazovanje objavljuje i novo objavljuje:

**KONKURS**  
Za popunu slobodnih radna mesta

- OSNSH "Deshmoret e Tivarit"-Peçane**
  - Jedan nastavnik/ca za predmet albanskog jezika
  - Koeficienta : A-421
- OSNSH " Sadri Duhla"-Dule**
  - Jedan nastavnik/ca za predmet Istorija-Građansko vaspitanje u L.Sope i Greqice(zumena za nastavnicu na porodiljsko odsustvo)
  - Koeficienta : A-421

**Uslovi:**Za ova slobodna radna mesta za nastavnice potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br.05/2021 i AU mont BR.08/2021

- OSNSH " Dituria"-Samadraxhe**
  - Jedan tehnički / pomoćni radnik-novo obavljenje
  - Koeficienta:A-4


**Dokumentacija potrebna za konkurs:**

- Obrazac (prijava) kokandidat popunjava
- Ekstrakt rođenja
- Lična karta (fotokopija)
- Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)
- Dokaz da nije pod istragom
- Dokaz o Radnom iskustvu u obrazovanju(ako ga ima)
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati nostrifikovane diplome MONT-a

Kopletirane dokumenti se dostavljaju u fotokopirano,dok će se originalni dokumenti podstavljavati u intervju.Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka.

Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelarija u Opštine Suva Reka.

**Konkurs ostaje otvoren 15(petnaest)dana od obavljenu u novinama.Orasporedu intervju bičete obaveshteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj table ODO.**



Direktor profete  
Remzi Bajselmani

# Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek **"REB BULLI"**, në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:  
**044-514-373 dhe 044-199-707.**

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

▶ Benjamin Arifi B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810026163.

▶ Selim Rami shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

▶ Branisllav Popovic shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmtl "11 Marsi " Prizren.

▶ Albert Jahdauti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Hysni Temaj " Kushnin Has.

▶ Arben Jahdauti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Hysni Temaj " Kushnin Has.

▶ Forian Fanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes " Vermic.

▶ Fize Kurtaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.

▶ Binak Qestaj nga Juniku shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve Mamive dhe Profesionistëve Shëndetësorë të Kosovës.

▶ Ideal Hilmi Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.P. "Gjon Nikoll Kazazi" Teknologji e PC-ve.

▶ Xhevat Abdullahi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Nëna Terezë" Vranidoll Prishtinë nga kl. I deri VIII .

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

**RESTAURANT**

---

**SWISS**

**TAVERNA**

---

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

